



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi Komunal
Hani i Elezit
Municipal Assambly

RREGULLORE PËR TRANSPARENCËN

HANI I ELEZIT
SHKURT, 2009

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale neni 68.4, Statutit të Komunës së Hanit të Elezit, neni 24, dhe Udhëzimit Administrativ 2008/9 për transparencën në Komuna.

Kuvendi Komunal i Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur me date; 2009, miraton këtë:

RREGULLORE MBI TRANSPARENCËN

KAPITULLI 1 Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është:

- 1.1. Forcimin e transparencës së organeve legjislative, ekzekutive dhe të administratës komunale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel lokal dhe
- 1.2. Lehtësimin e qasjes së publikut në dokumentet zyrtare të komunave.

Neni 2 Fushëveprimi

- 2.1. Ky dokument, rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij, mbledhjet me publikun, obligimin për njoftim publik, konsultimin e publikut para miratimit të akteve komunale dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumente zyrtare të komunës.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregullore:

- 3.1. **“Seancat e Kuvendit Komunal”**- janë mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshëm të anëtarëve të Kuvendit,
- 3.2. **“Komitetet”**- janë organe të Kuvendit Komunal,
- 3.3. **“Pjesëmarrja e publikut”**- do të thotë kycja e qytetarëve në vendimmarrje të organeve të pushtetit lokal,
- 3.4. **“Njoftimi i publikut”**- do të thotë publikimin e njoftimeve në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Kuvendit Komunal, publikimin e tyre në mediat lokale dhe internet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve.
- 3.5. **“Tubimet publike”**- janë tubime të organizuara nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij me qëllim të njoftimit të qytetarëve me punën e organeve komunale dhe ngritjen e çështjeve të ndryshme nga banoret,
- 3.6. **“Peticionet”**- janë kërkesa kolektive me shkrim që i adresohen Komunës respektivisht Kuvendit Komunal nga një grup i interesit apo organizata, rreth

- cilës do çështje që ka të bëjë me përgjegjësit e Komunës me qëllim që ajo të ndërmerret ndonjë veprim ose të përmbahet nga ndonjë veprim,
- 3.7. **“Konsultimi publik i akteve komunale”**- nënkupton seancë dëgjimore dhe marrjen e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të publikut para miratimit të aktit dhe
- 3.8. **“Qasja në dokumentet zyrtare”**- nënkupton shikimi i dokumenteve zyrtare të Komunës në pajtim me Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare.

Neni 4

Mbledhjet e Kuvendit Komunal

- 4.1. Mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe subjektet e interesuara për çështjet që është objekt diskutimi.
- 4.2. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit Komunal ose komitetit përkatës, siguron kushte dhe mundësit fizike për pjesëmarrje të publikut në vendin ku mbahet mbledhja.
- 4.3. Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit ose komitetit përkatës, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme, njoftimi për publikë bëhet përmes:
- a. Shpallja publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - b. Media e shkruar dhe elektronike lokale
 - c. Web faqen zyrtare të Komunës
- 4.4. Njoftimet publike sipas paragrafit 3 të këtij neni, domosdoshmërisht duhet të përmbajnë:
- a. Data e mbledhjes,
 - b. Kohën e mbledhjes,
 - c. Vendin e mbledhjes, dhe
 - d. Rendin e ditës
- 4.5. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës duhet të njoftojë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbledhjeve të jashtëzakonshme.
- 4.6. Mbledhjet e Kuvendit Komunal mund të jenë të mbyllura pjesërisht ose tërësisht vetëm për shkaqet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Në këto raste, me vendim të arsyetuar, Kuvendi Komunal i shpallë mbledhjet pjesërisht ose tërësisht të mbyllura për publikun.

Neni 5

Publikimi i akteve komunale

- 5.1. Të gjitha vendimet, rregulloret dhe aktet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet nga legjislacioni në fuqi për qasje në dokumentet zyrtare duhet të bëhen publike një javë pas mbledhjes në të cilën janë marrë vendimet, si më poshtë:
 - a. Shpallje publike në vend më të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - b. Median e shkruar dhe elektronike lokale dhe
 - c. Web-faqja e Komunës së Hanit të Elezit
- 5.2. Buxheti komunal dhe planet komunale janë dokumente publike. Komuna (me shpenzimet e saj) merr masa për t'i venë në dispozicion të publikut, mjeteve të informimit dhe palëve të interesuara në formë të plotë ose të shkruar sipas kërkesës.

Neni 6

Kërkesat për Informim dhe Peticionet

- 6.1. Çdo qytetar ose organizatë e interesuar ka të drejtë të parashtoj kërkesë për informacion për veprimtarinë e komunës ose ti drejtojë peticion Kuvendit të Komunës, për çështjet që janë përgjegjësi e komunës. Kërkesat ose peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit të përcaktuar me ligj.
- 6.2. Pas diskutimit në Kuvend, Kryetari i Komunës ose një zyrtar i autorizuar prej tij, jo më vonë se 30 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit.
- 6.3. Në rastet kur peticioni lidhet me çështje për të cilat komuna nuk është drejtpërdrejt kompetente, Kryetari i Komunës ose një zyrtar i autorizuar prej tij, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit se është jo kompetent dhe e procedon atë tek organi kompetent duke informuar edhe parashtruesin.

Neni 7

Takimet me publikun

- 7.1. Në pajtim me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, çdo vit Komuna detyrimisht mban të paktën dy tubime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, njëra nga takimet me publikun mbahet gjatë 6 (gjashtë) mujorit të parë të vitit.
- 7.2. Përveç dy takimeve të detyrueshme me publikun, Kuvendi i Komunës duhet të shqyrtoj mundësinë për të mbajtur mbledhje shtesë, sa më pranë qytetarëve (vendbanimeve, fshatrave, lagjeve), për çështje që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimit ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm.
- 7.3. Dy javë para mbajtjes së takimit publik, Kuvendi i Komunës, nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, informon publikun përmes:

- a. Shpallja publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - b. Media e shkruar dhe elektronike lokale
 - c. Web faqen zyrtare të Komunës
- 7.4. Njoftimet publike sipas paragrafit 3 të këtij neni, domosdoshmërisht duhet të përmbajnë:
- a. Data e mbledhjes,
 - b. Kohën e mbledhjes,
 - c. Vendin e mbledhjes, dhe
 - d. Rendin e ditës
- 7.5. Përveç takimeve publike të cekura më lartë, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me Statutin e Komunës.
- 7.6. Pjesëmarrja e zyrtarëve më të lartë komunal të tillë si; Kryetari i Komunës, Drejtorat e Drejtorive, Kryetarët e Komiteteve si dhe zyrtarët kompetentë për çështjen në diskutim është e obligueshme.
- 7.7. Kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku gjatë tubimeve evidentohen nga Drejtori i Administratës dhe shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda 30 ditëve pas përfundimit të tubimit publik.

Neni 8

Konsultimi Publik para Miratimit të Akteve Komunale

- 8.1. Aktet normative të Kuvendit të Komunës ose organeve tjera komunale, përfshirë, rregulloret dhe vendimet, i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit.
- 8.2. Organi propozues përgatit tekstin e projekt-aktit dhe cakton mënyrën e zhvillimit të konsultimit duke përfshirë në mënyrë të detyrueshme konsultime me grupet e interesit, seancat dëgjimore me publikun dhe forma të tjera të pjesëmarrjes së publikut.
- 8.3. Zyra përgjegjëse për informim njofton publikun dy javë para seancës së konsultimit publik ndër të tjera përmes;
- a. Shpallja publike në vendet me të frekuentuara brenda territorit të komunës,
 - b. Media e shkruar dhe elektronike lokale,
 - c. Web faqen zyrtare të Komunës.
- 8.4. Njoftimi publik sipas paragrafit 8.3 të këtij neni duhet të përmbajë domosdoshmërisht:
- a. Data e mbledhjes,
 - b. Kohën e mbledhjes,
 - c. Vendin e mbledhjes, dhe
 - d. Rendin e ditës.
- 8.5. Organi propozues i aktit merr pjesë aktivisht në konsultim, shpjegon përmbajtjen e aktit para publikut dhe evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë

konsultimeve. Propozimet shqyrtohen brenda një afati të arsyeshëm nga përfundimi i konsultimit.

- 8.6. Organi propozues i aktit duhet të informoj Kuvendin Komunal për propozimet e dhëna në diskutim publik, duke përfshirë propozimet e refuzuara si dhe ato të marra parasysh. Me rastin e miratimit të aktit, Kuvendi i Komunës kujdeset që propozimet e argumentuara të përfshihen në tekstin përfundimtar të projektit.

Neni 9

Qasja në Dokumentet Zyrtare të Komunës

- 9.1. Në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare, i shpallur me Rregulloren 2003/32, Komunitat garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet zyrtare të komunës.
- 9.2. Kryetari i Komunës ose një zyrtar tjetër i caktuar prej tij zbaton detyrimet ligjore që rrjedhin nga ligji dhe udhëzimet administrative në lidhje me qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 10

Plani i Veprimit për Transparencë në Komunë

- 10.1. Çdo komunë harton planin e veprimit për transparencë në komuna, pas hartimit dhe miratimit nga kuvendi i komunës, të rregulloreve komunale për transparencë. Shqyrtimi dhe miratimi i planit bëhet nga Kryetari i Komunës me qëllim që procesi i vendimmarrjes dhe veprimtaria komunale të bëhet më transparente.
- 10.2. Këto plane mund të përfshijnë ndër të tjera veprimet e mëposhtme si dhe iniciativa tjera të dizajnuara për të përmirësuar qasjen e publikut dhe transparencën në komuna.
- a. Raportimin më të shpeshtë në media për çështje që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje tjera me interes të përgjithshëm
 - b. Mbajtjen e konferencave periodike të shtypit me gazetar dhe përfaqësues të mediave lokale të informimit.
 - c. Organizimi i seancave me publikun e gjerë ose grupe të interesit për çështje me interes.
 - d. Ndërtimi i web faqes zyrtare të komunës ose freskimi i asaj ekzistuese me raporte të punës, kalendari i mbledhjeve etj.
 - e. Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve orientuese në lidhje me Organogramin, rregulloret e punës së Kuvendit të Komunës, informacione mbi dokumentacionin, informacione për shërbyesit civil, taksat komunale, tarifatat e shërbimeve komunale etj.
- 10.3. Plani për transparencë në Komunë, duhet të i mundësojë publikut monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi në Komunë duke përfshirë ndër të tjera

legjislacionin në menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, prokurimin, shërbimin civil, qasjen në dokumentet zyrtare, ligjin mbi ndërtimet, ligjin për planifikim hapësinor.

Neni 11
Përgjegjësia e zbatimit

- 11.1. Kuvendi i Komunës, si dhe Kryetari i Komunës, janë përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore.
- 11.2. Monitorimin e zbatimit të kësaj rregullore do ta bëjë Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit në Kuvendin Komunal .

KUVENDI KOMUNAL HANI I ELEZIT

Hani i Elezit

Kryesuesi I Kuvendit
Shaban Qupi
